

VENDIM
Nr. 113, datë 14.5.2018

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “OSOJA ENERGY” SHPK,
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAÏK SEMAN-1 SHEQ, MARINAS, FIER, ME FUQI TË INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.5.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me licencimin e shoqërisë “Osoja Energy” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-1, Sheq, Marinas, Fier, me fuqi të instaluar 2000 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Osoja Energy” sh.p.k., me shkresën e datës 11.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 310 prot., datë 11.4.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-1, Sheq, Marinas, Fier, me fuqi të instaluar 2000 kw.

- ERE, me vendimin me nr. 93, datë 20.4.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-1, Sheq, Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, me shkresën nr. 55/20 prot., datë 20.4.2018, u bë njoftimi në median e shkruar dhe me mbarimin e afateve të publikimit rezulton se nuk ka ndonjë kërkesë apo objeksion nga të interesuarit.

- Gjithashtu, ERE, me shkresën nr. 310/1 prot., datë 26.4.2018, i ka kërkuar subjektit “Osoja Energy” sh.p.k., të plotësojë dokumentacionin e munguar në aplikim për sa i përket oponencës teknike të projektit të zbatimit dhe vërtetimeve nga gjykata dhe prokuroria për statusin penal.

- Me shkresën e datës 10.5.2018, subjekti ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Osoja Energy” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Osoja Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-1, Sheq, Marinas, Fier, me fuqi të instaluar 2000 kw, për një afat 20-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti